



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA E ISTOGUT

KONTRATË PËR PUNË

KOMUNA E ISTOGUT në vazhdim "Njësia e Prokurimit", të cilën e përfaqëson z. **Gëzim Ademaj**, menaxher i Prokurimit, Rr. "Fadil Ferati" Nr. 121 në njërën anë;

Dhe

"NATONII" Shpk, Komuna e Istogut, të cilat i përfaqëson z. **Naton Kabashi**, me Nr. Unik Rexh. Biznesi, 810149478 (në vazhdim "Kontraktuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë:

TITULLI I KONTRATËS:

NDËRTIMI DHE RRETHIMI I POLIGONIT SPORTIV NË TRUBOHOC –LOT 3

Nr. I prokurimit	633-20-5771-5-2-1/ C 402 LOT 3
Nr. I brendshëm	633 / 020 / 096 / 521

Neni 1 Lënda:

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i furnizimeve dhe punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit:

NDËRTIMI DHE RRETHIMI I POLIGONIT SPORTIV NË TRUBOHOC –LOT 3

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i punëve për aktivitetin e prokurimit NDËRTIMI DHE RRETHIMI I POLIGONIT SPORTIV NË TRUBOHOC –LOT 3 është: 16.810,20 € dhe me fjalë: /Gjashtëmbëdhjetë mijë tetëdhjetë euro-20 /100 €

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve përgjatë ekzekutimit të kontratës.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

*Marrëveshja e kontratës;
Kushtet e Veçanta të Kontratës;
Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);
Plani për menaxhimin e kontratës*

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4. Afati i përmbushjës së kontratës:

4.1 Kontrata do të përmbushet ne afat prej 30 ditësh, nga data e nënshkrimit te se njëjtës, perkatesisht me se larti deri me: 11.12.2020

4.2 Në qoftë se Kontrata nuk permbushet ne afatin e paraparë, e njëjta do të ndërpritet dhe kompanija do të pergjigjet per demet eventuale që mund t'i shkaktohen Autoritetit Kontraktues, sipas kushteve te përgjithshme dhe të veçanta të kontratës.

Neni 5 Komunikimet

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për





pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

5.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues:
Komuna e Istogut

Për Kontraktorin:
"NATONII" Shpk

Emri	Gëzim Ademaj	Emri	Naton Kabashi
Pozita:	U.D. I Menaxher-it të Prokurimit	Pozita:	D r e j t o r
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	11. 11. 2020	Data:	11. 11. 2020
Vu la		Vu la	

PJESA III E KONTRATES kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë GJUHA SHQIPE
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është <i>10% e vlerës së përgjithshme të kontratës 10% e vlerës së kontratës, me vlefshmeri 30 dite me gjate perfundimi i kontratës.</i>
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: Sigurimi i vend punishtes do te jete përgjegjësi e Operatorit Ekonomik dhe te gjitha dëmtimet e punëve, dëmtimet e pronës apo humbjet e materialeve dhe pajisjeve ne vend punishte janë ne përgjegjësi te Operatorit ekonomik deri ne shumen e dëmtimeve apo humbjeve, sigurimi i vend punishtes do te jetë + 30 dite nga plani dinamik i ofruar pra nëse zgjasin punimet zgjatet edhe sigurimi i vend punishtes pra + 30 dite.
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të caktohet në <i>planin e menaxhimit</i>
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë <i>1muaj</i>
Regjistri i punës	20.1	Ditari i Punës dhe Libri ndërtimor
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit është <i>i caktuar me vendim të ZKA</i>
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë <i>5DITE</i> pas nënshkrimit të kontratës.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Palët do te provojnë ne mënyrë miqësore ti zgjidhin marrëveshjet ku do te organizojnë se paku tre takime për zgjidhje miqësore e nëse këto takime nuk kane efekt atëherë kompetente do te jetë gjykata.
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykata Themelore në Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë

lot 3

Ndertimi i fushes ne Trubuhovc

Nr. Ren	Kodi i mat.	Lloji i Materialit/ Peshkrimi	Njesia	Sasia e nevojshme	Çmimi për njësi	Totali
1	1.1	Gërmimi i dheut te kategoris se III dhe IV dhe bartja e materialit te germuar deri ne depomi me te afert.	m ³	495.00	0.40 €	198.00
2	1.2	Nivelizimi dhe ngjeshja e nënbazes se fushes në tërë sipërfaqen e saj me saktesi deri ne 3cm me grejder me modul te ngjeshjes 30-35MPa.	m ²	990	0.05 €	49.50
3	1.3	Furnizimi, transporti, shtruarja, rafshimi dhe ngjeshja e materialit mbushes zhavorik te granuluar nga guri i thyer (0-150mm) me trashesi t=30cm, ngjeshja te behet me cilinder 25tone deri ne moduln e ngjeshjes 50-60Mpa.	m ³	297	3.50 €	1,039.50
4	1.4	Furnizimi, transporti, shtruarja, rafshimi dhe ngjeshja e materialit mbushes zhavorik te granuluar nga guri i thyer (0-63mm) me trashesi pas ngjeshjes t=20cm, ngjeshja te behet me cilinder 25tone deri ne moduln e ngjeshjes 50-60Mpa.	m ³	198	4.50 €	891.00
5	1.5	Furnizimi, transporti, shtruarja, rafshimi dhe ngjeshja e materialit mbushes zhavorik te granuluar nga guri i thyer (0-31.5mm) me trashesi pas ngjeshjes t=10cm, ngjeshja te behet me cilinder 25tone deri ne moduln e ngjeshjes 80Mpa.	m ³	99	5.50 €	544.50
6	1.6	Furnizimi, transporti, shtruarja, rafshimi dhe ngjeshja e materialit mbushes zhavorik te granuluar nga guri i thyer (0-4mm) me trashesi pas ngjeshjes t=5cm, ngjeshja te behet me cilinder 25tone deri ne moduln e ngjeshjes 80Mpa.	m ³	49.5	7.00 €	346.50

7	1.7	Furnizimi, transporti dhe punimi i shtresës së asfaltit me asfaltbeton AB-16, TE MBYLLUR me trashësi 7cm pas ngjeshjes adekuate. Karakteristikat e asfaltit: fraksionet e asfaltit >2mm...45-82.5%, fraksionet e agregatit <2mm...27-49%, pjesa për mbushjen e poreve <0.09mm...3-6%, përqindja e filerit ndaj agregatit 4-10%, materiali lidhës - bitumen B50/70...5.3-6.5% dhe shkalla e ngjeshjes >97%.	m ²	968	7.90 €	7,647.20
	1.8	Shernejzimi I fushes me vija ndarese me mgyjre te bardhe	m ¹	280	0.50 €	140.00
	1.9	Furnizimi dhe montimi I golave ne fushen e futbollit te alumurit ose te metalit standarde me dim.(200x205x120)cm	copë	2	125.00 €	250.00
8	2	Furnizimi dhe montimi me rrijeta për maskimin e golave në fushën e futbollit të plastifikuara.dim.(200x205x120)cm.	copë	2	125.00 €	250.00
	Rrethoja e Poligonit sportiv te futbollit					
	1	Përgaditja e terrenit,pastrimi dhe planifikimi per fillimin e punimeve ne rrethojen e poligonit sportiv te futbollit	aprox		5	5.00
	1.1	Germimi I dheut te kategorisë III-IV për hapjen e gropave per vendosjen e shtyllave metalike per ndertimin e rrethojes metalike te poligonit	copë	94	0.4	37.60
	1.2	sportiv.Gropat duhet të jenë me dimensione 1.0x0.80cm.Hapia e gropave te behet ne cdo dy meter distancë njëra nga tjetra dhe atë per tërë perimetrin e poligonit				
	1.3	Furnizimi dhe vendosja e profileve metalike me dimensione 60x80x2mm.Profillet duhet te vendosen vertikalisht dhe atë ne cdo 2 meter distancë dhe atë ne vrimat e bera paraprakisht e duke llogaritur lartesisinë e rrethojes deri ne h=4m dhe pjesa e e futur nen sipërfaqe te tokës 1m.Në llogari te parashihet qe pas vendosjes se profileve te betonohet gropa dhe atë me beton te pa armuar- thjeshtë	m ¹	720	2.4	1,728.00
	1.4	Furnizimi dhe vendosja e profileve ne pjertësi per shtangimin e Vertikaleve dhe atë ne te gjitha vendet e mundshme dhe te nevojshme per shtangim.profillet duhet të jenë 80x60x2mm dhe me gjatësi L=7m	m ¹	180	2.4	432.00

1.5	Furnizimi dhe vendosja e profileve metalike me dimensione 40x40x2mm ne menyre horizontale dhe duke u salduar per profilet vertikale. Profilët duhet te vendosen ne 6 rende pas portave te futbollit ne distanca te njejta dhe atë, ndersa anash fushë te jen me 5 rende e ate lart , posht e 3 rende ne mes te hapsirës. Llogaria për meter gjatësi të perimetrit te poligonit	m'	1,120	1.35	1,512.00
1.6	Furnizimi dhe vendosja e rjetës se zingëtuar 2.5 mm me hapsira 5x5 cm , rjeta të llogaritet per tërë sipërfaqen e rrethojës e në llogari te parashihen edhe perkrahet tjera te nevojshme	m ²	928	1.45	1,345.60
1.7	Furnizimi dhe shtangimi i rjetës me tel të drejte(zingëtuar) me trashësi 2.5 mm .	m'	1,518	0.05	75.90
1.8	Furnizimi, dhe ngjyrosja me parangjyrë dhe ngjyrë adekuate per metal. Në llogari te futet ngjyrosja e profileve metalike	lit	170	1.5	255.00
1.9	Furnizimi dhe montimi i derës metalike me dimensione 2.0x1.10m Dera te jetë me kornizë 40x40mm dhe mbrendesi me armatur rjetore ø8m me hapsira 15x15 cm.ne llogari te parashihen edhe mekanizmi i Braves me cilinder.	cope	1	50	50.00
2.3	Furnizimi dhe ngjyrosja e derës metalike me parangjyre dhe me ngjyre dekorative.	lit	3	1	3.00
LOT03 - TOTALI ME TE GJITHA NGARKESAT					16,810.20